



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1386 / Prot. 1

Tiranë, më 10.07 2026

V E N D I M

Nr. 100 datë 10.07 2026

"PËR
MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM,
PËR VITIN 2027-2029 PËR UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS"

Mbështetur në nenin 38, të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-të e RSH", - Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", - Ligji nr.10296, datë 08/07/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, në Udhëzimin Plotësues nr. 6, datë 27.02.2026 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2027-2029", në Statutin e UST, në Vendimin e Rektoratit nr. 91 datë 03.07.2026, në shkresën e Administratorit me nr. 600/17 prot., datë 01.07.2026 " Dërgojmë për miratim Projekt Buxhetin Afatmesëm për periudhën 2027-2029 për Universitetin e Sporteve të Tiranës", në Relacionin e Administratorit me nr. 600/16 prot., datë 01.07.2029, "Mbi hartimin e programit buxhetor afatmesëm për periudhën 2027-2029 në UST", Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 03.07.2026,

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit të Programit Buxhetor Afatmesëm, për Universitetin e Sporteve të Tiranës, për vitin 2027-2029 dhe Projekt Buxhetin për vitin 2027, për Universitetin e Sporteve të Tiranës, sipas tabelave bashkëngjitur.
2. Ky Vendim i dërgohet Bordit të Administrimit për miratim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron Kasa

